



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

Nr. 19 /7, datë 30 / 10 /2023

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIMIN E STATUSIT “INVESTIM/
INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR”
PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “EURON SOLAR PV – 50 MW”, BASHKIA
FIER
ME SUBJEKT APLIKUES SHOQËRINË “EURON” SHPK,
ME NUIS/NIPT: J71317002N”**

Në mbështetje të neneve 9, 13, dhe 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/a të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti i investimit propozon ndërtimin e një parku fotovoltaiik me një fuqi të instaluar prej 50MWp i cili do të ndërtohet në 3 faza, me prodhim vjetor 41.25m kwh në fazën e parë, 66.0m kwh në fazën e dytë, dhe 82.50m kwh në fazën e tretë.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 37,500,000 (tridhjetë e shtatë milion e pesëqind mijë) Euro.
- Projekti do të realizohet në një sipërfaqe totale prej 89.17 ha, në ZK 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier prej të cilave 35.39 ha janë pronë në pronësi private, pjesa tjetër prej 53.78 ha është në pronësi shtet e cila kërkohet si masë mbështetëse nga shteti.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE
VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Euron Solar Pv – 50 MW”, Bashkia Fier, me subjekt investues shoqërinë “Euron” shpk, me NUIS/NIPT: J71317002N në procedurën e asistuar dhe mbështetjen që ofron ky status.

2. Për zonën prej 53.78 ha në ZK. 3038, në pronësi shtet, për të cilën kërkohet masa mbështetëse e vendosjes në dispozicion të kësaj pasurie shtetërore, rezulton se ka një sërë aktesh ligjore të mbivendosura që e prekin në mënyrë direkte situatën juridike të pronës.
3. Projekti i propozuar është në mospërputhje të pjesshme me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Fier.
4. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuesit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA